



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2023

Lënda: Kthim përgjigje

I nderuar

Në vijim të shkresës Tuaj, të administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 1806, datë 06.02.2023 Ju informojmë se:

I. Bashkia në procesin e integrimit evropian

Procesi i integrimit evropian është sfida por njëkohësisht edhe prioritet kryesor për Bashkinë Shkodër. Një element i rëndësishëm në procesin e integrimit evropian është ngritja e strukturave përkatëse dhe ngritja e kapaciteteve administrative në nivel vendor për tu ballafaquar me sfidat që procesi i integrimit evropian sjellë. Parë në këtë këndvështrim Bashkia Shkodër ka parashikuar në strukturën e saj organizative *Sektorin e planifikimit strategjik, integrimit evropian, migracionit dhe diasporës* si sektorin përgjegjes për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve të Bashkimit Evropian. Konkretisht Bashkia Shkodër është angazhuar në një proces intensiv përafrimi me instrumentat e BE dhe rezultatet e këtij angazhimi janë konkretizuar në marrjen pjesë në projekte ndërkufitare, përgjegjëse për këtë proces është ky sektor. Në pozicionin e punës së këtij sektori janë specifikuar detyrat e nëpunësve civil që kanë të bëjnë specifikisht me bashkërendimin dhe koordinimin e procesit evropian.

Sektori i planifikimit strategjik, integrimit evropian, migracionit dhe diasporës është pjesë e programit buxhetor P04130 Mbështetje për zhvillim ekonomik. Në buxhetin vjetor dhe PBA të Bashkisë Shkodër është integruar VKB datë VKM nr. 450, datë 26.07.2018 sëbashku me fishat e tjera që kanë si tematikë integrimin evropian.

P04130.Q1.O2.A1. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Evropian, Organizata të tjera ndërkombëtare dhe kombetare si dhe anëtaresimi në shoqata ndërkombëtare.

P04130.Q1.O2.A2. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian nëpërmjet Këndit të BE Shkodër.

P04130.Q1.O2.A3. Diaspora dhe migracioni

Në varësi të fushave dhe natyrës së projekteve, zbatimi i tyre bëhet nga drejtoritë respektive.

Veprimtaria e këtij sektori mbështetet në këto komponentë kryesor:

1. Koordinim i brendshëm për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, në kuadër të përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Performanës së Bashkive në Procesin e Integritimit Evropian: "Bashkitë në dhe procesin e Integritimit të Shqipërisë në Bashkimit Evropian".
2. Ngritjen e kapaciteteve për përthitjen e fondeve nga programet europiane dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira.
3. Qendër reference ku publiku të mund të marrë informacion për çështjet, Programet e BE-së, etj.
4. Ure komunikimi ndërmjet komunitetit, strukturat vendore/qendrore, ambasadave si dhe strukturave të Delegacionit të BE-së në Shqipëri.
5. Organizim eventesh për çështjet e BE-së/Ditët e BE,së Ditët Kombëtare të Vendeve Anëtare, etj.

Lista e projekteve fituese të Bashkisë Shkodër janë në kuadër të programeve më poshtë:

6. Programi: BNK Mali i Zi Shqipëri
7. Programi: BNK Itali – Shqipëri – Mali i Zi
8. Programi: Adriatic-Ionian INTERREG V-B
9. Programi: IADSA Programme
10. Programi: HORIZON 2020
11. Programi: EuropeAid
12. Programi: Europa për qytetarët
13. Programi: RDPA
14. Programi: ReLOaD
15. Programi: EU për Bashkitë

Bashkia Shkodër është anëtare e Forumit të qyteteve që lagen nga deti Adriatik Jonian FAIC dhe njëkohësisht anëtare e bordit drejtues të kësaj shoqate.

II. Bashkia dhe shoqëria civile

Një ndër objektivat tona është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, për ofrimin e shërbimeve në territor. Ndër shërbimet që ofrohen në bashkëpunim me organizatat janë; fuqizimi socio-ekonomik i familjeve në vështirësi ekonomike, shërbimet alternative të kujdestarisë familjare, mbështetja dhe integrimi i personave me aftësi ndryshe, deinstitutionalizimi, ri-integrimi i fëmijëve migrantë apo të rikthyer nga emigracioni, përfshirja sociale për romët dhe egjiptianët, si një shtysë e mirë për integrimin e këtij komuniteti, mbrojtja dhe trajtimi i viktimave të dhunës në familje, buxhetimi me pjesëmarrje dhe përfshirja e qasjes gjinore në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës, promovimi i territorit të Bashkisë Shkodër, promovimin e produktit territorial. Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër në rrugën “13 Dhjetori” dhe “28 Nëntori”; Mbështetja dhe zhvillimi i Sportit, sipas metodologjisë LOD.

Gjithashtu herë pas herë janë vënë në funksion tryeza të përbashkëta konsultative me shoqërinë civile. Synimi i këtyre tryezave është konsolidimi i bashkëpunimit, vlerësimi i nevojave dhe ofrimi i shërbimeve në përputhje me nevojat e territorit dhe buxhetimi me pjesmarrje.

Shkodër Bashkia disponon listen e shoqatave dhe mediave që operojnë në territorin e saj. Mesatarisht Bashkia Shkodër nënshkruan rreth 15 marrëveshje bashkëpunimi, megjithatë nuk mungojnë edhe bashkëpunime të tjera me OSHC-të për të cilat jo detyrimisht është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Format e bashkëpunimit me shoqërinë civile janë të ndryshme dhe për rrjedhojë procedurat e ndjekura për dhënien e granteve nga Bashkia Shkodër ndaj organizatave të shoqërisë civile janë disa, përmendim këtu marrëveshjet e bashkëpunimit dy palëshe, transfertën, prokurimin me vlerë të vogël, procedurat e ndjekura me Thirrje të hapur në kuadër të Programit Reload, përjashtimin nga detyrimet tarifore. Transfertë specifike për shërbime sociale.

a. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile në kuadër të Programit ReLOaD.

Bashkia Shkodër zbatoi metodologjinë LOD të Programit ReLOaD në 4 programe buxhetore të saj, në fushën kulturore, artistike, sportive dhe rinore. Disa nga rezultatet që Bashkia Shkodër synon të arrijë në çdo partneritet me të gjitha organizatat në Shqipëri janë:

- Përdorimi i modeleve transparente dhe të bazuara në projekte konkrete për financimin e OSHC-ve;
- Ofrimi i shërbimeve për qytetarët në zbatim të planeve dhe strategjive lokale për zhvillim;
- Ngritja e kapaciteteve të OSHC-ve për të zbatuar skemat e grantit dhe ofruar projekte cilësore;
- Përmirësimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile.

Në vitin 2022 u realizua thirrja e pestë publike për projekt propozime. Në këtë këtë thirrje aplikuan 16 OSHC nga të cilat 7 shoqata u shpallen fituese. Totali i grantit në Bashkinë e Shkodrës për këtë Thirrje ishte 10.840.000 ALL. Ndërsa vlera e projekteve të fituara për organizatat e shoqërisë civile ishte 7,239,000 lekë.

b. Metodologjia LOD, Programi Reload për Sportin.

Bashkia Shkodër ka aplikuar Metodologjinë LOD për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive në respektim të ligjit 79/2017 ‘Për Sportin’, i ndryshuar. Paketa është miratuar e plotë në Këshillin Bashkiak. **Ky proces është një risi në menaxhimin e disiplinave sportive në Shqipëri** dhe vjen në zbatim të nenit 19 dhe 21 të ligjit 79/2017 ‘Për Sportin’, I ndryshuar. Nëpërmjet këtij procesi janë menaxhuar 15 disiplina sportive, 21 ekipe sportive,

36 trajnerë. Në përfundim të procesit janë nënshkruar 15 kontratë shërbimi me shoqatat sportive.

c. Procesi i organizimit të Thirrjes sipas Metodologjisë LOD/Programi ReLOaD.

I gjithë procesi për përcaktimin e prioriteteve të thirrjes publike për OSHC-të është tërësisht i hapur dhe transparent. Për çdo Thirrje të hapur Bashkia Shkodër organizon dy dëgjesa publike me OSHC-të:

1. Dëgjesa e parë zhvillohet përpara shpalljes së thirrjes. Në këtë takim përcaktohen fushave prioritare, mbi bazën e të cilave do të organizohen thirrjet publike për organizatat e shoqërisë civile.
2. Pas shpalljes së Thirrjes, Bashkia Shkodër organizon Ditën e hapur/Sesionin informues për kriteret e thirrjes.

Për secilën degjësë kontaktohen organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Shkodër nëpërmjet postës elektronike të Bashkisë Shkodër info@bashkiashkoder.gov.al dhe planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al si dhe nëpërmjet telefonit.

Njëkohësisht, Bashkia Shkodër publikon për çdo rast njoftimin në faqen zyrtare të saj www.bashkiashkoder.gov.al si dhe në rrjetet sociale.

d. Emërimi i një përfaqësuesi të OSHC-së në Komisionin e Vlerësimit të projekteve.

Projekt propozimet shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit. Organizatat e shoqërisë civile përfaqësohen në komisionin e vlerësimit nga një anëtar i OSHC-së me të drejta të barabarta me anëtarët e tjerë. Përzgjedhja e këtij anëtari bëhet me shpalljen e një thirrje të hapur për përfaqësuesit e të gjitha organizatave të shoqërisë civile. Njoftimi i Thirrjes Publike publikohet në faqen web <https://www.bashkiashkoder.gov.al> si dhe në median sociale të Bashkisë Shkodër.

Gjithashtu për këtë shpallje kontaktohen me email organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Shkodër nëpërmjet postës elektronike.

e. Shërbime sociale

Bashkia Shkodër në fushën e shërbimeve sociale, ka ofruar mbështetje financiare për disa organizata të tilla si: The Door, Madonnina Del Grappa, Projekti Shpresa, Shoqata Paratraplegjikëve, si më poshtë vijon:

	Organizata	Forma Mbështetjes	Buxheti (mije leke)
1	The Door	Honorare, transport,	367

2	Madonnina Del Grappa	Transfertë pakushtëzuar sektoriale	16,600
3	Projekti Shpresa	Transfertë pakushtëzuar sektoriale	20,051
4	Shoqata Para tetraplegjikëve	Refreshment	50

f. Politikat fiskale

Bashkia Shkodër ka parashikuar lehtësira fiskale me VKB nr.1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar, në të cilën specifikohen rastet e përjashtimit nga detyrimet tarifore për OSHC-të. Përsa i përket liçensimit të OSHC-ve, ju informojmë së ky nuk është një funksion i pushtetit vendor.

III. Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Koordinator: Fisnik Lutfija

Email: lutfija.fisnik@bashkiashkoder.gov.al

Të dhënat e koordinatorit për njoftim dhe këshillim i gjeni të publikuara në linkun:

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Pjesemarrja_qytetare_ne_vendimmarrje_1100_1.p hp

IV. Buxhetimi me pjesmarrje.

Konsultimi i buxhetit të bashkisë për çdo program buxhetor; zhvillimi ekonomik, turizmi, investimet, shërbimet publike, shërbimet sociale, etj., me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin dhe palë të interesuara është jo vetëm një detyrim ligjor por edhe një praktikë e mirë e Bashkisë Shkodër.

Procesi ka ecur paralelisht me harmonizimin e dokumentave strategjike që Bashkia Shkodër disponon si dhe me organizimin e një sërë takimesh konsultative me aktorë dhe palë të interesuara për të adresuar nevojat konkrete të tyre. Sa më sipër është miratuar kalendari i hartimit të Programit Buxhetor Afat-Mesëm (PBA) dhe është përcaktuar veprimtaria e punës së Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP). Këto ekipe janë angazhuar në organizimin e një sërë takimesh konsultative në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Pjesë e pa ndarë e këtij procesi kanë qënë edhe konsultimet e tjera publike të cilat Bashkia ka ndërmarrë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të saj.

Ky proces realizohet në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftim dhe Konsultim Publik”. Konkretisht janë ndjekur të gjithë hapat ligjor sipas ligjit për Konsultimin me Publikun. I gjithë informacioni është lehtësisht i aksesueshëm në faqen web të Bashkisë Shkodër, në rubrikën Këshillim me Publikun.

Në çdo rast në faqen web të Bashkisë Shkodër publikohet:

1. Njoftimi i Konsultimit Publik
2. Kalendar i Konsultimit Publik
3. Procesverbali i Takimit Publik

E njëjta procedurë ndjeket edhe në rastin e hartimit të dokumentave strategjike, si strategjia territoriale e Bashkisë Shkodër, planeve vendore dhe projekteve apo investimeve strategjike në linkun: https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Keshillim_me_Publikun_301_1.php

Për vitin 2022 janë organizuar 12 takime gjatë periudhës së përgatitjes së buxhetit. Konsultimet publike janë realizuar me anë të takimeve në Njesitë Administrative dhe në Lagje, sipas kalendarit të publikuar në faqen web. Informacioni është i aksesueshëm në faqen web të Bashkisë Shkodër, në rubrikën Këshillim me Publikun në linkun si mëposhtë: https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Njoftim_per_keshillim_me_publikun_Per_draftin_e_projektplanit_buxhetor_afatmesem_2022_2024_2021_1.php

Propozimet e dhëna nga grupet e interesit janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në buxhet/PBA duke siguruar një shpërndarje të barabartë të investimeve.

Së fundi, listën e marrëveshjeve kryesore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me OSHC-të si dhe të gjitha dokumentat e përmendura mësipër mund ti gjeni të publikuara në faqen e Bashkisë Shkodër, në linkun mëposhtë:

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Bashkia_dhe_shoqeria_civile_1206_1.php

V. Plani vjetor për procesin e vendimarrjes

Informacionin e plotë të planit vendor për procesin e vendimarrjes e gjeni të publikuar në linkun:

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Plani_vjetor_per_procesin_e_vendimarrjes_me_pjesmarrje_per_vitin_2022_2397_1.php

Konsultimi realizohet nëpërmjet takimeve publike dhe informacionin për numrin e akteve të konsultuara gjatë vitit 2022 e gjeni të publikuar në linkun:

https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Keshillim_me_Publikun_301_1.php

VI. Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje

Projekt aktin dhe relacionin shpjegues për tu konsultuar me publikun mund ta gjeni në faqen e internetit - Këshillim me Publikun.

Brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, mund të dorëzoni komente dhe rekomandime me postë në adresën: Bashkia Shkodër, rruga “13 Dhjetori”, nr.1, Shkodër ose me postë elektronike në adresën: lutfija.fisnik@bashkiashkoder.gov.al.

Vendi, data dhe ora e konsultimit me publikun është në faqen zyrtare të internetit <http://www.bashkiashkoder.gov.al-Këshillim> me Publikun.

Me respekt,

KRYETAR

Bardh Spahia